



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR
NPL "PALLATI I RINISË", SHA

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së "Pallati i Rinisë", SHA.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 125.000,00 € (njëqind e njëzet e pesë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, NPL-së "Pallati i Rinisë", SHA, për të forcuar kapacitetet dhe operacionet e ndërmarrjes, si: rivitalizimi i hapësirave që do të jepen me qira, shpenzimet për certifikimet e obliguara të stafit në fushën e sigurisë publike, shpenzimet e digjitalizimit të proceseve, shpenzimet e ngrohjes dhe ndriçimit.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e NPL-së "Pallati i Rinisë", SHA.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-215761/23, më 03.11.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci

